Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH, NË VEPRIMTARINË NË QENDRËN "ROMANI BAXT"

9 prill 2013

I nderuar z. Furtuna,
Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë e veçantë të jem i pranishëm për të folur këtu sot, sepse më kujton edhe vizitën e vitit të kaluar, në nëntor. Ishte që atëherë një situatë e gëzueshme, por kam përshtypjen, ashtu si edhe miqtë e mi, se veprimtaria e sotme është edhe më e bukur. Prandaj jam i kënaqur që mund të flas me ju me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve, apo më mirë të Javës, siç u tha me të drejtë. Sepse nuk bëhet fjalë vetëm për një ditë; është një punë më e gjatë dhe ne jemi përpjekur të krijojmë një bazë pune. Kur shoh këtë posterin pas meje shoh një bazë – shohim simbolin e ODIHR-it dhe të BE-së – një punë e përbashkët e mbështetur nga Shtetet pjesëmarrëse, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të kontribuar në jetën tuaj tani dhe për një të ardhme më të mirë. Fillon me përfshirjen dhe përfshirja fillon me ju, kështu që s'kishte si të ishte më mirë; fillon me këtë qendër komunitare si dhe me punën që bëni këtu dhe në mjediset e katit të dytë – një nga gjërat që mbaj mend nga vizita e kaluar ishte kopshti i fëmijëve.

ODIHR-i, zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, misionet e OSBE-së, pjesë e së cilave është Prezenca, si dhe Bashkimi Evropian, bashkëpunojnë ngushtë në lidhje me projektin për "Praktikat më të Mira për Integrimin e Romëve", që ka për qëllim integrimin e romëve në mbarë rajonin. Ky projekt është një tjetër shembull i partneritetit të mirë ndërkombëtar.

Përqasja rajonale për trajtimin e problemeve rajonale është përqasja e duhur, qoftë në këtë apo në fusha të tjera ku kemi interesa të përbashkëta dhe ku hasim sfida serioze. Është për një arsye të mirë që bashkëpunimi bën pjesë në vlerat thelbësore dhe si rrjedhojë është pjesë e veprimtarive kryesore të Organizatës që ne, unë dhe bashkëpunëtorët e mirë në Prezencën e OSBE-së dhe në ODIHR, përfaqësojmë me krenari.

Në këtë kuadër, rëndësia e mbrojtjes së kulturës rome dhe garantimi i integrimit të romëve në shoqëritë tona demokratike nuk është thjesht një kriter kushtetues. Të 57 Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë marrë përsipër angazhime të detyrueshme politike, të cilat janë shumë kërkuese, si për shembull Vendimi i Këshillit Ministerial të Helsinkit të vitit 2008 "Për Rritjen e përpjekjeve të OSBE-së për zbatimin e Planit të Veprimit për Përmirësimin e Situatës së Komunitetit Rom dhe Sinti në zonën e OSBE-së".

Kjo është një fushë me rëndësi të madhe për ekipin tim dhe për mua personalisht.
Ka një histori të gjatë bashkëpunimi midis Prezencës së OSBE-së dhe autoriteteve shqiptare për përmirësimin e situatës së romëve. Për shembull, Prezenca ka kontribuar në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës për Romët.

Kemi asistuar, gjithashtu, në hartimin e legjislacionit kundër diskriminimit dhe kemi mbështetur ngritjen e zyrës së Komisionerit Kundër Diskriminimit, duke përfshirë edhe botimin e materialeve kundër diskriminimit në gjuhët e folura nga pakicat e popullsisë.

Fatkeqësisht, është fakt i trishtuar që minoriteti rom në Shqipëri dhe, do të debatoja, edhe në mbarë rajonin, vuan nga diskriminimi i vazhdueshëm, mungesa e qasjes në shërbimet bazë dhe nga pamundësia për t'u përfaqësuar plotësisht në jetën politike. Përfshirja politike dhe përfaqësimi i tyre është kyç. Nuk duhet toleruar më gjatë fakti që romët nuk janë pjesë e sferës publike të këtij vendi dhe as e proceseve vendimmarrëse.

Për këtë arsye duhen marrë masa të veçanta dhe të menjëhershme për të siguruar që ata t'i gëzojnë plotësisht të të drejtave të tyre, si çdo qytetar tjetër shqiptar.

Në këtë kontekst, mbrojtja nga diskriminimi nuk mjafton. U bëj thirrje të gjitha institucioneve të garantojnë që përfshirjen e romëve dhe kulturës së tyre në politikat dhe veprimtaritë e tyre, si dhe që romët të përfshihen edhe në mes radhëve të tyre.

Për shembull, kam bërë shpesh thirrje për përfshirjen e romëve dhe grupeve të tjera minoritare në strukturat shtetërore si Policia dhe institucionet vendore.

Për më tepër, kultura rome duhet ruajtur dhe zhvilluar si një pjesë përbërëse e Trashëgimisë Kulturore Kombëtare të Shqipërisë. Shumëllojshmëria e kulturës rome, gjuhës, muzikës dhe artit ka një vend qendror në trashëgiminë e pasur të Shqipërisë dhe mbarë Ballkanit. Artistët romë duhen mbështetur. Mendoj gjithashtu se është mirë të merret në konsideratë një studim i duhur dhe mjete për dokumentimin e studimeve mbi kulturën rome.

I nderuar z. Furtuna,
Zonja dhe zotërinj,

Dëshiroj të falënderoj "Romani Baxt", dhe ju personalisht, z. Gimi Furtuna, si dhe të gjithë bashkëorganizatorët që na kujtuat jo vetëm pasurinë e trashëgimisë kulturore rome por edhe rëndësinë e adresimit të çështjeve jetësore me të cilat përballet komuniteti romë në jetën e përditshme.

Le të kalojmë të gjithë një Ditë dhe një javë të gëzueshme Ndërkombëtare të Romëve. Bashkë me ju, shpresoj të shijojmë pjesët muzikore dhe kërcimet që presin të fillojnë pas fjalëve tona.

Ju falënderoj!

Fund